




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.17, datë 08.05.2023

PËR



**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK  
SHOQËRISË “DELIU 3D” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Deliu 3D”, sipas Kontratës me Nr. 1894 Rep., Nr. 1092/2 Kol., datë 29.08.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Shiroku”, me kapacitet prodhues 1.600 MW”. me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe përroit të Hotomizës me derdhje në përroin e Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

**HEC Shiroku**

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujor përroi i Holtës

- X= 530857; Y= 4536163; Z=1188 m.m.n.d. (KRGJSH)



- Prurja llogaritëse: 0.47 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.33 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.28 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.024 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujqor përroi i Hotomizës

- X= 528239; Y= 4534753; Z=1195 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.17 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.12 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.08 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.007 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e godinës së centralit

- X= 529907; Y= 4533331; Z=870 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 0.64 m<sup>3</sup>/s
- Prurja për bujqësinë: 0.03 m<sup>3</sup>/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 5,962,399 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 1600 kwh
- Vlera totale e investimit: 279,103,372.8 lekë.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH), ku kanali i largimit të godinës së HEC-it Shiroku takon trupin ujqor pritës, përroin e Holtës .

- X= 529974; Y= 4533303; Z=868 m.m.n.d. (KRGJSH)

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN**

**LEFTER SHEHAJ**

